REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 58/17
Datë/Datum. 28.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: ***KOMUNA FUSHË KOSOVË***

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: ***6120 16 097 221***

Sa i përket tenderit për : ***Mirëmbajtja e rrjetit të ujesjellësit dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transproti i mbeturinave.***

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.SH.T "KANALPROFIS"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Bedri Pejani Nr. 5
(Adresa)

Fushë Kosovë — *(Vendi)*
10000 — *(Kodi postar)*

044/159-997 — *(Numri Telefonit)*
600017900 — *(Numri i Faks-it)*

Yzeir Ajeti
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

kanalprofis@hotmail.com
(Adresa elektronike)

28.02.2017
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Ndërmarrja shërbyese-tregtare KANALPROFIS * KOSOVË *

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:
Kompanin N.SH.T "KANALPROFIS" , nuk përfaqëson ndonjë Avokat.

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Aktivitetin e prokurimit e ka publikuar AK – i Fushë Kosovës. Me datën 27-12-2016 është shpallur Njoftimi për Kontratë. Me datën 30-01-2017 është shpallur Njoftimi për Dhënje të Kontratës. Me datën 30-01-2017 është dërguar letra standarde për tenderuesin e suksesshëm. Me datën 14-02-2017 është shpallur Njotimi për Anulimi për Dhënje të Kontratës. Me datën 22-02-2017 nga OE i'u është dërguar AK kërkesa për rishqyrtim. Me datën 23-02-2017 është dërguar vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

Përfaqësuesi i Kompanisë "KANALPROFIS" ka qen prezent në Hapje të Tenderit, dhe çdo gjë ka qenë në rregull.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Me datën 22-02-2017 kemi bërë kërkesën për rishqyrtim pran AK. Me datën 23.02.2017 AK – i Fushë Kosovës ka kthyer pergjigje si në vijim: *"I. Refuzohet kërkesa (ankesa) e propozuar për shqyrtim si e pa bazë, e Operatorit Ekonomik N.SH.T "KANALPROFIS" nga F. Kosovapër shqyrtimin e aktivitetit të prokurimit për tenderitn: Mirëmbajtja e rrjetit të ujesjellësit dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transproti i mbeturinave. Me Nr të prokurimit 6120 16 097 221.* **Për më tepër informacion rreth "Vendimit" të AK-së shih dokumentin me nr.Protokolit 03 të datës 23.02.2017.**

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontratktues ka shkelur dispozitat e LPP-së si në vijim:
Neni 1.1, 1.2, 1.3 .
Neni 6.1, 6.2 .
Nenin 3.5

** *Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues fillimisht ka ndjekur procedurat sipas LPP, pastaj është ndikuar nga OE "ER-LIS" sh.p.k & "VE-MOR" sh.p.k , i cili ka rezultuar në anulimin e lëndës, i cili ndikim ka bërë AK të bëjë shkelje esenciale të LPP-së.

Sqarim:
AK, pas Vlerësimit ka kërkuar sqarime nga "KANALPROFIS" për tre(3) pozicione të paramasës, se janë çmime të ulëta, ne kemi bërë sqarimin edhe pse pozicionet me çmim të ulët kanë qen një sasi mjaft e vogël që nuk ka far ndikimi financiar te kompania "KANALPROFIS", dhe si garancë edhe më e madhe ne kemi garantuar sigurim bankar deri në 30 për qind nëse ndihen jo të sigurt rreth ekzekutimit të kontratës. AK e ka kuptuar se ne kemi qasje serioze ndaj lëndës në fjalë dhe ka vazhduar procedurat duke shpallur:

1. Njoftimin për Dhënje të Kontratës.
2. Letrën standarde për tenderuesin e suksesshëm.

Pas shpalljes së dokumentave të lartcekur, OE "ER-LIS" sh.p.k & "VE-MOR" sh.p.k , si duket ka kërkuar qasje në dokumentacionin e OE "KANALPROFIS" dhe pastaj AK iu është bindur OE "ER-LIS" sh.p.k & "VE-MOR" sh.p.k , për të anuluar të gjithë procedurën. Kjo situatë të bënë të dyshosh se mund të ketë ndonjë nuancë të manipulimit të situatës në mesë të AK dhe "ER-LIS" sh.p.k & "VE-MOR" sh.p.k , duke shkelur Neni 3.5 .

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Fillimisht mos nënshkrimi i kontratës, kompanis "KANALPROFIS" kërcënohet t'i shkaktoj, duke reflektuar në reduktimin e stafit punues si dhe në rënje ekonomike të kompanisë për tri vitet e ardhshme.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Anksesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*